



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË

Nr. 2082

**AKT-MIRATIMI**

**ORGAN I MIRATUAR**

**I VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT.**

Mbështetur në Kreun V të ligjit Nr. 10489, datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore" i ndryshuar, Urdhrin e Ministrit Nr. 53 datë 05.10.2017 "Për miratimin e rregullores "Për procedurat e miratimit dhe mbikëqyrjes së organeve evropiane të notifikuara dhe organeve të miratuara të vlerësimit të konformitetit" si dhe në Çertifikatën e Akreditimit me Nr. Regjistrimi **TI 029 Trupë Inspektuese**,

**MIRAT O J:**

Subjektin:	"Ergi-Pink" shpk.
Me Administrator:	Ervis Kaçuli
Me Drejtues Teknik:	Jorgji Gulka, Gencian Sollaku, Gëzim Hate, Perikli Gjiguria
Adresa e subjektit:	Rruga "Elbasan-Metalurgjik", pasuria 986, Bradashesh, Elbasan
Celular:	0674952790
E-mail:	info@ergipink.com

të ushtrorë veprimtarinë si Organ i Miratuar i Vlerësimit të Konformitetit (OMVK)

Tipi i OMVK-së:	Tipi A
Fusha e Veprimtarisë:	<p><b>I. Vlerësim konformiteti në fushën e inspektimit të ENP për:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pajisjet nën presion stacionare;</li> <li>• Pajisjet nën presion me vatra zjarri;</li> <li>• Inspektimi dhe rikualifikimi i rezervuarëve të gazit të lëngëzuar të naftës (GLN) me kapacitet më të vogël ose të barabartë me 13m<sup>3</sup>, mbi tokë;</li> <li>• Inspektimi dhe rikualifikimi i rezervuarëve të gazit të lëngëzuar të naftës (GLN) me kapacitet më të madh ose të barabartë me 13m<sup>3</sup>, mbi tokë;</li> <li>• Inspektimi i tubacioneve teknologjike brenda objektit dhe aksesorët e sigurisë;</li> <li>• Pajisjet nën presion, enët kriogjenike;</li> <li>• Rezervuarët mbitokësore të depozitave të hidrokarbureve të</li> </ul>

lëngët;

- Inspektimi i çisternave automobilistike, Klasa 2,3,8 ADR;
- Inspektimi i tubave fleksibël të presionit;
- Inspektimi i tubave fleksibël të presionit (për GLN dhe gazin natyror);

## **II. Vlerësim konformiteti në fushën e inspektimit Mekanik për:**

- Vinça të lëvizshëm;
- Vinça kullë;
- Vinçave urë;
- Vinçave portuale;
- Vinçave urë dhe me krah;
- Vinçave cjav;
- Vinçave portabël hidraulik;
- Vinçat për servisimin e mjeteve;
- Vinç flamur;
- Vinçat për të ngritur njerëzit në një platformë pune ne lartësi;
- Autoviça;
- Vinça të instaluar në kamion;
- Blloku Ngritës me ganxhë;
- Sonda shpimi nëntoke;
- Pajisje ngritëse elektrike me zinxhir;
- Pajisje ngritëse elektrike;
- Pajisje ngritëse elektrike me kavo;
- Pajisje ngritëse me operim manual;
- Krik hidraulik;
- Pajisje ngritëse hidraulike;
- Pajisje për tërheqje dhe ngritje me kavo;
- Arganello mekanike/hidraulike;
- Pirunët ngritës;
- Transpalete;
- Struktura të përkohshme;
- Pajisjeve mbrojtëse personale (PPE) për punime në lartësi;
- Aksesorë të përdorura për operacionet e ngritjes dhe pjesë e makinerive dhe pajisjeve ngritëse;

## **III. Vlerësim konformiteti në fushën e inspektimit Elektrik për:**

- Inspektim i instalimit elektrik në ambiente të zakonshme;
- Inspektim i impiantit elektrik në ambient me rrezik zjarri;
- Inspektim i pikave të shpërndarjes TL dhe nënstacioneve elektrike;
- Inspektim të impiantit të mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike;
- Inspektim i kabinave elektrike TM/TU
- Inspektim i linjave kabllore me tension 0.4, 6, 10 dhe 20 kV;
- Inspektimi i tokëzimit në instalimet elektrike;
- Inspektimi i fushës elektromagnetike për pajisjet dhe instalimet elektrike;
- Inspektim i linjave të tensionit mbi 1000 V dhe të tensionit të ulët 0.4 kV;

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Inspektimi i dispozitivit diferencial të vendosur në pajisjet instalimet dhe impiantet elektrike;</li> <li>• Inspektimi i mbrojtjes katodike.</li> </ul> <p><b>IV.</b> Lëshimin e Vërtetimit Teknik për respektimin e normave dhe kushteve teknike në instalimet teknologjike, për subjektet që kryejnë aktivitetin e përpunimit, transportit dhe tregëtimit në fushën e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.</p>
<p>Aktet ligjore/rregullat teknike për produktet/pajisjet/instalimet e vëna në treg:</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ligji nr. 10489, datë 5.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve joushqirnore”, i ndryshuar.</li> <li>2. VKM nr. 1060, datë 23.12.2015 “Për Miratimin e rregullit teknik “Për Makineritë” dhe përcaktimin e listës së tandarëve të harmonizuara.</li> <li>3. VKM nr. 1062, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit Teknik “Për pajisjet dhe bashkësitë nën presion”.</li> <li>4. Vendim Nr. 482, datë 17.6.2020 “Për miratimin e rregullës teknike, “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension të lartë, mbi 1 kV”.</li> <li>5. VKM nr. 483, date 17.6.2020 “Për miratimin e rregullës teknike, “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike të tensionit të lartë, mbi 1 kV”.</li> <li>6. VKM nr. 245, datë 30.03.2016 “Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat teknike në instalimin dhe kontrollin e dispozitivit diferencial, vendosur në pajisjet, impiantet dhe instalimet elektrike” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara.</li> </ol>
<p>Periudha e vlefshmërisë:</p>	<p>Deri më 02.02.2030</p>
<p>Territori i ushtrimit të veprimtarisë:</p>	<p>Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>
<p>Personi përgjegjës:</p>	<p>Ervis Kaçuli Administrator Edlir Peçi Menaxher Cilësie</p>
<p>OMVK regjistrohet me Nr. Identifikimi:</p>	<p style="text-align: center;"><b>OMI 009 Rishikim 4</b></p>

**OMVK detyrohet të plotësojë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, kërkesat dhe kushtet sa më poshtë:**

1. Është përgjegjës për veprimtarinë e vlerësimit të konformitetit, të kryera sipas objektit dhe afatit të këtij miratimi si dhe çdo veprimtari tjetër të kryer, përfshirë veprimtarinë nënkontraktuese.
2. Nuk duhet të përfshihet në veprimtarinë që mund të krijojnë konflikt me pavarësinë/paanësinë e tij të gjykimit ose integritetin për aktivitetet e vlerësimit të konformitetit, për të cilat ai është miratuar;
3. Siguron se veprimtarinë e degëve ose nënkontraktorëve të tij nuk prekin/ndikojnë në konfidencialitetin, objektivitetin, paanësinë e veprimtarive të tij të vlerësimit të konformitetit;
4. I siguron Ministrin (Strukturës Administrative Përgjegjëse me kërkesë zyrtare) brenda 10 ditësh, kopje të certifikatave, raporteve të testeve dhe të vlerësimit të konformitetit, përfshirë dokumentet për to si dhe informacionin për lëshimin, refuzimin ose tërheqjen e certifikatave për çdo subjekt;
5. Detyrohet të informojë Ministrin pa vonesë për çdo rast, në të cilin ky organ bëhet i paafte të sigurojë përmbushjen e kushteve të vendosura për ushtrimin e miratimit të vlefshmërisë së konformitetit;
6. Informon brenda 5 ditësh Ministrin (SAP) për çdo refuzim, kufizim, pezullim ose tërheqje certifikate;

7. Informon Ministrin për çdo kërkesë për informacion, të cilën ai ka marrë nga Inspektorati Shtetëror në vartësi të MIE-s për veprimtarinë e vlerësimit të konformitetit;
8. Detyrohet të mbajë regjistra të plotësuar rregullisht të të gjitha procedurave të vlerësimit të konformitetit, për të cilat ai është miratuar dhe të rezultateve të tyre për jo më pak se 10 vjet.
9. Me kërkesë të ministrit përgjegjës detyrohet të marrë pjesë në testime ose krahasime të tjera të përcaktuara për OMVK-të;
10. Në fund të çdo periudhe katërmujore, detyrohet ti dërgoje Ministrin (SAP) regjistrin e inspektimeve ose certifikatave të lëshuara për periudhën në fjalë;
11. Organi i Miratuar detyrohet t'u krijojë akses të plotë punonjësve të SAP, të pajisur me urdhër të Ministrin, të hyjnë në të gjitha ambjentet ku ka kryer vlerësim të konformitetit të përcaktuar në miratimin e lëshuar, në rastet e kërkesës për evidentim të të dhënave për përmbushjen e kritereve të vlerësimit të konformitetit;

Në rast të konstatimit të mos plotësimit të kërkesave dhe kushteve sipas pikave 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9, 10, 11, ose në rast se organi i miratuar nuk arrin të përmbushë më, një apo disa kritere a kërkesa të përcaktuara në rregullat teknike përkatëse apo në rregullat për sigurinë e produktit/instalimit të vendosur në shërbim përdorim dhe kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit, SAP i propozon Ministrin pezullimin e Aktit të Miratimit, deri në afatin e dhënë për plotësimin e tyre.

Nëse Organi i Miratuar dështon në plotësimin e kushteve dhe kërkesave sa më sipër brenda afatit të caktuar, SAP përgatit dhe i paraqet për firmë Ministrin urdhërin për shfuqizimin e Aktit të Miratimit dhe heqjen e emrit të OMVK-së nga regjistri i organeve të miratuara.

Datë: 05 / 03 / 2026

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
DHE MINISTËR  
Belinda Balluku**

**Me autorizim  
Zv. MINISTRI**

**Erlind Sulo**



REPUBLICA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
TIRANË